

3.6 SHIRITI I STATUSIT

Shiriti i statusit shtrihet në anën e poshtme të dritares. Në të janë të shfaqura informacionet kryesore rreth procedurave, të cilat për momentin zbatohen në redaktuesin e regjistrimit.

Shiriti i statusit përmban këto të dhëna:

- baza e të dhënave – shfaqet akronimi i bazës së të dhënave, në të cilën ndodheni
- maska – e dhëna tregon maskën e përzgjedhur për shënimin e të dhënave
- niveli – shfaqet niveli hyrës dhe dalës i detyrimit
- madhësia – shfaqet e dhëna rreth gjatësisë së regjistrimit në bajt
- regjistrimi – e dhëna tregon statusin e regjistrimit
- procedura – e dhëna tregon procedurën e krijimit, përkatësisht redaktimit të regjistrimit